



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 20 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 52, shkronja h) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dhe kërkesës së Zyrës së Bashkimit Evropian, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2016, miratoi këtë

V E N D I M

- I.** Miratohet Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës sipas kërkesës së Zyrës së Bashkimit Evropian, pa procedurë konkurrimi.
- II.** Vendimi i Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban:
 - a. Pjesën e parcelës kadastrale 5811-0, sipërfaqja 21 m², nga parcela 5816-0, sipërfaqja 5 m², si dhe nga parcela 5818-0, sipërfaqja 31 m², në sipërfaqe të përgjithshme prej S= 57 m² ZK Prishtinë.
- III.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij Vendimi, është 15 vjet.
- IV.** Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij Vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- V.** Kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe nga përfaqësuesi i subjektit të cekur në pikën I të këtij vendimi.
- VI.** Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta, evidentohen në regjistrin e të drejtave pronësore.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 046-247365, më 03.10.2016



KRYETAR I KUVENDIT
Halim Halimi /jur. i dipl.